



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr.

1591

Prishtinë, Dt.

03.06.2026

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	ShMN
Departamenti/ Programi	Biologji/Biologji
Projektpropozimi	Veçoritë faunistike dhe ekologjike të merimangave (Arachnida: Araneae) në Komunën e Vitisë Faunistic and ecological features of spiders (Arachnida: Araneae) in the Municipality of Viti
Kandidati	Eriona Mustafa
Mentori	Prof. Dr. Halil Ibrahim
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 14.07.2025
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 2379

Vlerësimi i dorëshkrimit

Tema e masterit, "**Veçoritë faunistike dhe ekologjike të merimangave (Arachnida: Araneae) në Komunën e Vitisë**" i kandidatit Besnik Çitaku është punuar në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, përkatësisht laboratorin e Zoologjisë të Universitetit të Prishtinës.

Dorëshkrimi është i shkruar në 43 faqe me radhor normal ku janë të përfshirë këta kapituj: Hyrja, Materiali dhe metodat e punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, dhe Referencat. Gjithashtu në punim janë të prezantuar: 14 tabela dhe 8 figura. Kandidati gjatë shkuarjes së dorëshkrimit ka shfrytëzuar literaturë të begatshme përkatësisht 32 njësi bibliografike dhe burime tjera nga interneti.

Puna është zhvilluar sipas dinamikës së paraparë me planin dhe programin e punës dhe është

rëalizuar në tri faza:

1. Hulumtimi në bazë të të dhënave të literaturës dhe puna praktike eksperimentale në teren.
2. Përpunimi i të dhënave, dhe
3. Shkrimi i tezës së masterit.

Qëllimi i kësaj teme të masterit ka qenë vlerësimi i faunës së arcanidave dhe aspektet taksonimike të llojeve të merimagnoreve Balkanin Përendimor. Me anë të këtij hulumtimi janë ofruar 30 lloje të merimagave që i përkasin 14 familjeve. Studimi është kryer në 10 lokalitete lokale të ndryshme në komunën e Vitisë

Në kapitullin e Hyrjes kandidati përshkruan në përgjithësi karakteristikat, grupeve shtazore të hulumtuara, rendësin e tyre dhe ekosisteme. Gjithashtu në këtë kapitull janë përfshirë edhe qëllimi i hulumtimit sëbashku me pikat kyçe të këtij hulumtimi si dhe karakteristikat e grupeve shtazore të konstatuar gjatë këtij hulumtimi.

Në kapitullin Materiali dhe Metodën e punës janë paraqitur të dhënat për përzgjedhjen e objektit të hulumtimit, mënyrën e hulumtimit në teren dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, dhe sekuencimi i mostrave. Në këtë kapitull shpjegohet në detaje metoda e marrjes së mostrave, konservimi i tyre si dhe determinimi.

Në kapitullin Rezultatet kandidati jep detajisht të dhënat e fituara gjatë këtij hulumtimi. Të dhënat janë paraqitur në formë tabelare dhe në formë grafike duke e pasqyruar për secilin lokalitet përzierjen e faunës së merimangave

Në kapitullin e Diskutimit kandidati i diskuton të dhënat e fituara gjatë këtij hulumtimi me hulumtimet e kryera më parë.

Adaj, konsiderojmë se kandidati i ka plotësuar të gjitha kushtet për të propozuar KSHM të Departamentit të Biologjisë përkatësisht FSHMN që të aprovojë këtë raport dhe të lejojë kandidatin mbrojtjen e kësaj teme të masterit me titullin e lartshënuar.

Prishtinë,

20.05.2016

Komisioni:

1.

Hakim

/ Prof. Hakim mentor/

2.

Luljeta

/ Prof. Luljeta anëtar/

3.

Arif

/ Prof. Arif anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.